

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimi të Formimit Profesional Publik FIER

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË

“MODELIM VESHJESH PËR FEMRA”

Kodi: MVF-2019

Miratoi:

DREJTOR

.....

Fier, 2019

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“Modelim veshjesh për femra”

(MVF 2019)

I. Profili Profesional i Modelist veshjesh për femra

a) Karakteristikat e Modelim veshjesh për femra

Modelisiti veshjesh për femra është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar në ndërmarrje të ateliesë apo si i vetëpunësuar për prodhimin e veshjeve për femra .

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, modelisti duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe **shprehi** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale në fushën e modelimit .

Suksesi i modelist veshjesh për femra është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, korrektësia, disiplina, etika e komunikimit etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e modelistit veshjesh për femra

Me përfundimin me sukses të këtij kursi, ai/ajo mund të punësohen në subjekte private ose si i/e vetëpunësuar, pra mund të punësohet si modelist në: fasoneri, atelie, të punojë individualisht në një biznes të vogël modelimi. Pas një përvoje të mëtijshme kursanti/ja mund të hapë biznesin e vetë të drejtuar e menaxhuar nga vetë ai/ajo. Modelisti i veshjeve për femra ka mundësi për karrier profesionale duke kaluar në faza të ndryshme të profesionit .

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Modelim Veshjesh për Femra.

Në përfundim të kursit për “Modelim veshjesh për femra ”, kursantët do të jenë të aftë të: konsultohen me klientët për porositë e marra;

- parapërgatisin vendin e punës për fillimin e punës;
- përzgjedhin dhe përdorin mjetet dhe materialet e punës;
- bëjnë marrjen e masave për veshjen e kërkuar;
- përdorin dokumentacion për modelim;
- përzgjedhin ngjyrat e veshjeve , llojit të materialit sipas stinëve ,tendencës , të modës dhe preferencës së klientëve;
- kryejnë llogaritjen e kostos së porosisë;
- përcaktojnë modelin dhe materialit të duhur ;
- kryejnë modelime të ndryshme sipas kërkesave të klientëve ;
- përpunojnë kallëpin e veshjes së kërkuar sipas masave dhe modelit të përzgjedhur nga klienti;
- bëjnë prerjen e copës në përputhje me kallëpin apo përmasat e klientit;
- kryejnë pasinë me penj kopjues në bazë të prerjes;
- kryejnë qepjen paraprake sipas llojit të veshjes;
- realizojnë ildisjen sipas llojit të veshjes;
- kryejnë vendosjen e frazelinës;
- bëjnë provën e veshjes në trup ose në manikin;
- kryejnë modifikimet e veshjes pas nxjerrjes nga prova;

- kryejnë kontrollin përfundimtar të veshjes;
- vendosin aksesore dhe dekoracione të ndryshme;
- hekurosën dhe paketojnë veshjen e porositur;
- kryejnë riparime të ndryshme (zgjerime, ngushtime apo përshtatje) sipas kërkesës së klientit;
- kryejnë mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës;
- zbatojnë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojnë standardet e profesionit të modelimit;
- komunikojnë me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Modelim veshjesh për femra”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Modelim veshjesh për femra” duhet të jenë mbi 18 vjeç , të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të kenë marrë më parë trajnimin në rrobaqepsi.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Modelim veshjesh për femra”

440 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Modelim veshjesh për femra”

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e modelistit të veshjesh për femra.	MVF-01-2019	20 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1.Kursanti përshkruan profesionin e modelistit të veshjeve për femra. 2. Kursanti përshkruan veshjet, materialet dhe mjetet e punës së modelistit të veshjeve për femra. 3.Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit, sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes në modelim të veshjeve për femra.
2	Modelimi, prerja, qepja e fustaneve me pala, verëf, me kinda.	MVF-02-2019	180 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit kallëpin bazë të fustanit me pala material skub, verëf material krep, me kinda material saten. 2.Kursanti kryen modelimin e kërkuar mbi kallëpin bazë të fustanit me pala material skub, verëf material krep, me kinda material saten. 3. Kursanti pret fustanin me pala material skub, verëf material krep, me kinda material saten. 4.Kursanti qep fustanin me pala material skub, verëf material krep, me kinda material saten. 5. Kursanti kryen procesin përfundimtar të fustanit me pala material skub, verëf material krep, me kinda material saten.

3	Modelimi, prerja, qepja e fundit me pala dhe xhepa.	MVF-03-2019	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit kallëpin bazë të fundeve për femra me pala dhe xhepa. 2. Kursanti kryen modelimin e kërkuar mbi kalëpin bazë të fundeve për femra me pala dhe xhepa. 3. Kursanti pret fundin për femra me pala dhe xhepa. 4. Kursanti qep funde për femra me pala dhe xhepa . 5. Kursanti kryen procesin përfundimtar të fundeve për femra me pala dhe xhepa.
4	Modelimi, prerja, qepja e pantallonave klasike, fund - pantallona.	MVF-04-2019	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit kallëpin bazë të pantallonave klasike, fund-pantallona. 2. Kursanti kryen modelimin e kërkuar mbi kalëpin bazë të pantallonave klasike për femra, fund-pantallona. 3. Kursanti pret pantallonat klasike për femra, fund - pantallona. 4. Kursanti qep pantallonat klasike për femra, fund - pantallona. 5. Kursanti kryen procesin përfundimtar të pantallonave klasike për femra, fund - pantallona.
5	Modelimi, prerja, qepja e këmishave klasike për femra.	MVF-05-2019	40 orë mësimore 10%teori 80%praktikë 10% vlerësime	1. Kursanti përgatit kallëpin bazë të këmishave klasike për femra . 2. Kursanti kryen modelimin e kërkuar mbi kalëpin bazë të këmishave klasike për femra. 3. Kursanti pret këmishat klasike për femra, me material krep. 4. Kursanti qep këmisha klasike për femra. 5. Kursanti kryen procesin përfundimtar të këmishave klasike për femra.
6	Modelimi, prerja, qepja e xhaketave klasike për femra.	MVF-06-2019	80 orë mësimore 10%teori 80%praktikë 10% vlerësime	1. Kursanti përgatit kallëpin e xhaketave klasike për femra. 2. Kursanti kryen modelimin e kërkuar mbi kallëpin bazë të xhaketave klasike për femra. 3. Kursanti pret xhaketat klasike për femra. 4. Kursanti qep xhaketat klasike për femra. 5. Kursanti kryen proceset përfundimtare të xhaketave klasike për femra.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko - praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko - praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet në nivel qendre.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Modelim veshjesh për femra:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e Modelistit të veshjesh për femra”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E MODELIST TË VESHJESH PËR FEMRA	MVF-01-2019
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të modelistit me produktet, materialet dhe proceset e modelistit, rregullat e komunikimit, aftësitë dixhitale për të kërkuar, hulumtuar, kushtet e kontratës së punës si dhe me rregullat e sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm ,të jenë mbi 18 vjeç dhe të ketë marrë trajnim mbi kursin Rrobaqepsi.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan profesionin e modelistit të veshjeve për femra. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë e sektorit të modelimit të veshjeve për femra në ekonominë e vendit; - të përshkruajë rolin dhe ndikimin e veshjeve tek individit dhe shoqëria; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së modelistit të veshjeve për femra; - të përshkruajë dokumentacion e duhur; - të përshkruajë mjediset dhe kushtet e punës së modelistit. - të përshkruajë proceset bazë të modelimit; - të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdor modelisti; - të përshkruajë organizimin e punës në modelim; - të përshkruajë kërkesat profesionale për modelim veshjesh për femra; - të tregojë mundësitë e punësimit të modelistit; - të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të	

modelistit;

- të zbatojë aftësitë dixhitale për të kërkuar rreth profesionit të modelistit dhe hulumtuar rreth tendencave të reja;
- të tregojë procedurën për liçensimin e veprimtarisë së modelistit veshjesh për femra;
- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet për qepjen e pensave;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit;
- të përshkruajë elementët e Kontratës së Punës, detyrat, afatet, koha etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan veshjet, materialet dhe mjetet e punës së modelistit të veshjeve për femra.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të dallojë veshjet sipas moshës, lëndës së parë dhe stinës së përdorimit të tyre;
- të përshkruajë shkallën e komoditetit që sigurohet me anë të zgjedhjes së materialit;
- të tregojë karakteristikat e higjienës së veshjeve si mbajtja e nxehtësisë së trupit, thithja e djersës si dhe përçueshmëria e ajrit;
- të përshkruajë tendencat e modës në botë në bazë të katalogëve dhe tendencave;
- të përshkruajë pamjen estetike të materialit të zgjedhur sipas funksioni të cilësisë dhe kostos;
- të dallojë materialet bazë që përdoren për veshje si lino, saten, skub, pambuku, liri, kërpi, mëndafshi, sintetike etj.;
- të përshkruajë materialet ndihmëse dhe aksesoret e modelistit si astar, frazelinë, penj, kopsa, susta, zinxhir, garnitura të ndryshme, vata, penj, llastikë etj.;
- të përshkruajë funksionin e mjeteve për matje dhe shënime si metër shirit, vizore njëmetroshe, kurbalinjë, sapun shkrues, shkumës etj.;
- të sistemojë dhe mirëmbajë mjetet dhe vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë prerjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit, sigurisë,

higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit në modelim të veshjeve për femra.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rregullat dhe rëndësinë e komunikimit me etikë profesionale me klientin dhe me të tjerë;
- të përshkruajë rëndësinë dhe rregullat e sigurimit teknik që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga rryma elektrike, dëmtimet nga makinat dhe pajisjet prerëse, dëmtimet nga nxehtësia dhe zjarri etj.;
- të përshkruajë masat dhe mjetet për mbrojtjen nga zjarri;
- të përshkruajë masat dhe mjetet për dhënien e ndihmës së parë për të dëmtuarit;
- të përshkruajë rregullat e higjienës personale dhe rëndësinë e mbajtjes pastër dhe të rregullt të mjediseve të punës;
- të përshkruajë rëndësinë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë punës së modelistit të veshjeve për femra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë, ateliesë, fasonerisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të modelimit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në modelim. Atyre duhet ti jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të modelistit, të dallojnë veshjet, materialet dhe mjetet e punës, si dhe të përshkruajnë rregullat e komunikimit, sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit në rrobaqepsi. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës në modelim.
-

- Komplete veshjesh për femra .
- Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në modelim.
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Modelimi, prerja, qepja e fustaneve me pala, verëf, me kinda”

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MODELIMI, PRERJA, QEPJA E FUSTANEVE ME PALA, VEREF, ME KINDA	MVF-01-2019
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e punimeve të modelimit, prerjes , qepjes së fustaneve me pala me material skub, verëf me material krep dhe me kinda material saten si dhe i aftëson ata të kryejnë matje, shënime, prerje, qepje me dorë, hekurosje dhe frazelimin e copave dhe të materialeve ndihmëse.	
Kohëzgjatja e modulit	180 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm ,të jenë mbi 18 vjeç dhe të ketë kryer modulin “Hyrje në profesionin e Modelistit të veshjesh për femra.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përgatit kallëpin bazë të fustanit me pala me material skub, verëf me material krep, me kinda material saten. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përgatisë vendin e punës; - të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë; - të përgatisë copën për fustanin me pala me material skub; - të përgatisë copën për fustanin verëf me material krep; - të përgatisë copën për fustanin me kinda me material saten; - të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit të fustanit; - të shpjegojë mënyrën e realizimit të ndërtimit të kallëpit të prerjes së fustanit me pala me material skub; - të shpjegojë mënyrën e realizimit të ndërtimit të kallëpit të prerjes së fustanit verëf me material krep; - të shpjegojë mënyrën e realizimit të ndërtimit të kallëpit të prerjes së fustanit me kinda me material saten;	

-
- të marrë masat e klientit për fustanin me pala me material skub;
 - të marrë masat e klientit për fustanin verëf me material krep;
 - të marrë masat e klientit për fustanin me kinda me material saten;
 - të komunikojë me etikë profesionale;
 - të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë përgatitjes së kallepit të fustanit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti kryen modelimin e kërkuar mbi kallepin bazë të fustanit me pala material skub, verëf me material krep, me kinda material saten.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përzgjedhë veglat, materiale dhe pajisjet e nevojshme për punë;
- të përshtasë modelin sipas tendencave të modës;
- të përzgjedhë copën, ngjyrën dhe materialet ndihmëse për fustanet me pala, verëf, me kinda;
- të modelojë palat e fustanit me material skub;
- të modelojë kindat e fustanit me material saten;
- të modelojë formën e verëfit të fustanit me material krep;
- të kontrollojë masat e klientit për fustanet me pala, verëf, kinda;
- të kryejë shënimet mbi bazën e letrës për modelin e kërkuar;
- të shënojë me mjete shënuese mbi letër;
- të kryejë transformimin e modelit nga baza mbi letër të pastër;
- të shënojë me mjete shënuese mbi copë, duke respektuar shënimet e duhura për të realizuar modelin e kërkuar;
- të kryejë ildsjen sipas shënimeve të palave, kindave;
- të kryejë pasinë sipas shënimeve për të përcaktuar simetrinë e fustanit;
- të sistemojë vendin dhe mjetet e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë prerjes së fustanit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti pret fustanin me pala material skub, verëf material krep, me kinda material saten.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përzgjedhë veglat, materiale dhe pajisjet e nevojshme për punë;
- të përzgjedhë copën , ngjyrën dhe materialet ndihmëse për fustanin;
- të kontrollojë masat e klientit për fustan;
- të vendosë kallëpin e bazës së fustanit në copë;
- të shënojë me shkumës modelin e fustanit;
- të shënojë hapësirat e qepjes sipas modelit të fustanit;
- të shënojë pensat në pjesën e përparme dhe të mbrapme të fustanit në copë;
- të vendosë kallëpin e mëngës në copë;
- të shënojë me shkumës kallëpin e mëngës së fustanit;
- të shënojë hapësirat e qepjes për mëngën e fustanit;
- të vendosë kallëpin e jakës (nëse ka) sipas modelit në copë;
- të shënojë me shkumës kallëpin e jakës (nëse ka);
- të presë me gërhëre copën sipas shënimeve duke ekonomizuar copën;
- të presë mostrat e fustanit në copë;
- të presë me frazelinë pjesët e duhura të fustanit;
- të sistemojë vendin dhe mjetet e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë prerjes së fustanit.

Instrumente e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vlerësimi me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti qep fustanin me pala material skub, verëf material krep, me kinda material saten.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përzgjedhë veglat, materialet, makinat dhe pajisjet e nevojshme për punë;
- të kryejë qepjen e bazës së trupit;
- të kryejë qepjen të fustanit palave;
- të kryejë qepjen të fustanit verëf;
- të kryejë qepjen të fustanit me kinda;
- të kryejë qepjen e mëngëvë të fustanit;
- të kryejë qepjen e trupit me mëngët e fustanit;
- të kryejë ngjitjen me hekur të frazelinës;
- të kryejë qepje më vete të jakës së fustanit;
- të kryejë tegelat e zbukurimit të jakës (nëse ka);
- të kryejë qepjen e zinxhirit të fshehtë ose normal të fustanit;
- të kryejë qepjen e mostrave të fustanit;
- të kryejë qepjen e xhepave mbi fustan (nëse ka);
- të kryejë proven e dytë të fustanit;
- të shënojë difektet pas provës së fustanit;
- të kryejë rregullimet (rregullarin) e duhura pas provës së fustanit;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë prerjes së fustanit.

Instrumente e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti kryen procesin përfundimtar të fustanit me pala material skub, verëf material krep, me kinda material saten.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë;
- të kryejë proceset përfundimtare të qepjes me dorë të fustanit me pala;
- të kryejë proceset përfundimtare të qepjes me dorë të fustanit verëf;
- të kryejë proceset përfundimtare të qepjes me dorë të fustanit me kinda;
- të kryejë qepjen e palës së fustanit me dorë ose me ngjitje;
- të kryejë qepjen e palës së mëngëve me dorë, me ngjitje;
- të kryejë qepjen e zinxhirit, sustave, etj.;

- të kryejë hekurosjen përfundimtare të fustanit;
- të kryejë paketimin e fustanit;
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës;
- të llogarisë koston e konfeksionimit të fustanit;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë prerjes së fustanit.

Instrumente e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë, fasoneri, atelie.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, përdorimin e paisjeve dixhitale për tendecat, stilet, aksesoret, ngjyrat, materialet si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Rekomandohet të përdoren metodat e praktikës së pavarur dhe punë e mbikëqyrur.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi, fasoneri, atelie. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për përgatitjen e modelit, kallëpit të fundit, prerjen dhe qepjen e tij, si dhe për qepjen e fundeve me pala dhe xhepa , fillimisht të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore dixhitale.
 - Mjedise reale të punës në rrobaqepsi , fasoneri, atelie.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në rrobaqepsi, fasoneri, atelie.
 - Makina qepëse.
 - Copa dhe materiale ndihmëse të ndryshme për përgatitjen e fundeve me pala dhe xhepa.
 - Sica dhe katalogë të fundeve me pala dhe xhepa .
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Modelimi, prerja, qepja e fundit me pala dhe xhepa”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MODELIMI, PRERJA, QEPJA E FUNDIT ME PALA DHE XHEPA	MVF-03-2019
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurat e përgatitjes së modelimit, prerjes, qepjes së fundit me pala dhe xhepa, si dhe i aftëson ata për përgatitjen e kallëpit të fundit me pala dhe xhepa, prerjen dhe qepjen e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësim.e	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm ,të jenë mbi 18 vjeç dhe të ketë kryer modulet “Hyrje në profesionin e Modelistit të veshjesh për femra” dhe “Modelimi, prerja, qepja e fustaneve me pala, verëf, me kinda”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përgatit kallëpin bazë të fundeve për femra me pala dhe xhepa. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e ndërtimit të kallëpëve të prerjes së fundit me pala dhe xhepa; - të përzgjedhë metodën e duhur për ndërtimin e kallëpëve të prerjes së fundit me pala dhe xhepa; - të përzgjedhë materialet, mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e kallëpëve të prerjes së fundit me pala dhe xhepa; - të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit; - të realizojë skicën e fundit me pala dhe xhepa sipas kërkesave të klientit; - të marrë masat e nevojshme tek klienti; - të shpjegojë mënyrën e realizimit të ndërtimit të kallëpit të prerjes të fundit me pala dhe xhepa; - të ndërtojë kallëpët e prerjes së fundit me pala dhe xhepa . - sipas përmasave reale; - të kontrollojë saktësinë e kallëpëve të prerjes; - të vendosë shenjat përkatëse të referimit; - të presë kallëpët e fundit me pala dhe xhepa; - të sistemojë mjetet dhe vendin e punës; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Kursanti kryen modelimin e kërkuar mbi kallepin bazë të fundeve për femra me pala dhe xhepa.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e e prerjes së pjesëve të fundit me pala dhe xhepa;
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e e prerjes së pjesëve të fundit me pala dhe xhepa;
- të përshtasë modelin me tendecat e modës;
- të përshtasë ngjyrë e pëlhurës me modelin dhe kërkesës së klientit;
- të modelojë xhepat të fundeve për femra;
- të modelojë palat sipas tendencave dhe kërkesës së klientit;
- të përcaktojë gjatësinë e materialit;
- të përgatisë pëlhurën për prerje duke zgjedhur drejtimin e duhur;
- të vendosë sipas drejtimit të duhur kallëpët mbi pëlhurë;
- të shënojë mbi pëlhurë pjesët përbërëse të kallëpëve;
- të shënojë mbi pëlhurë rezervat e qepjes;
- të presë pjesët e fundit sipas kallëpëve të prerjes duke ekonomizuar lëndën e parë;
- të shënojë dhe kompletojë si duhet pjesët e prera;
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti pret fundin me pala dhe xhepa.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e qepjes së fundit të thjeshtë;
- të përzgjedhë materialet, mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e qepjes së fundit të thjeshtë;
- të përgatisë makinat e nevojshme për punë;
- të kopjojë me penjë kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme, tek shpina dhe përparësja e fundit;
- të ildisë pensat e fundit;
- të hekurosë pensat e fundit;

- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e fundit;
- të kryej provën e qëndrimit në trup të fundit;
- të kryej rregullimin e fundit pas kryerjes së provës;
- të qepë sipas rradhës fundin me pala dhe xhepa;
- të fiksojë drejt materialin ngjites me pëlhurën;
- të qepë astarin;
- të qepë fundin me pala dhe xhepa;
- të qepë zinxhirin në fundin me pala dhe xhepa;
- të bashkojë astarin (nëse ka) me fundin;
- të kryejë punime të nevojshme përfundimtare;
- të kontrollojë saktësinë e proceseve të qepjes së fundit me pala dhe xhepa;
- të vendosë aksesorë të ndryshëm;
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të fundit me pala dhe xhepa;
- të paketojë dhe ambalazhojë fundin me pala;
- të llogarisë koston e produktit të realizuar;
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti qep funde për femra me pala dhe xhepa.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e qepjes së fundit me supanjë dhe pala;
- të përzgjedhë materialet, mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e qepjes së fundit me supanjë dhe pala;
- të përgatisë makinat e nevojshme për punë;
- të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit;
- të realizojë skica të modeleve të ndryshme të fundeve me supanjë dhe pala;
- të marrë masat e nevojshme tek klienti;
- të përpunojë kallëpin e veshjes së kërkuar sipas masave dhe modelit;
- të llogarisë madhësinë e palave sipas modelit;
- të ndërtojë kallëpët e prerjes së fundit të modeluar sipas përmasave reale;
- të kontrollojë saktësinë e kallëpëve të prerjes;
- të presë kallëpët e fundit me pala dhe xhepa;
- të përcaktojë gjatësinë e materialit për prerje;
- të përgatisë pëlhurën për prerje duke zgjedhur drejtimin e duhur;
- të vendosë sipas drejtimit të duhur kallëpët mbi pëlhurë;
- të shënojë mbi pëlhurë pjesët përbërëse të kallëpëve;

- të vendosë shenjat përkatëse të referimit;
- të shënojë mbi pëlhurë rezervat e qepjes;
- të presë pjesët e fundit sipas kallëpëve të prerjes duke ekonomizuar lëndën e parë;
- të shënojë dhe kompletojë si duhet pjesët e prera;
- të kopjojë me penjë kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme, tek shpina dhe përparësja e fundit;
- të ildisë palat deh xhapat e fundit sipas cikatjeve;
- të hekurosë palat dhe xhepat e fundit;
- të bashkojë me ildi pjesët e fundit me pala;
- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e fundit;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të fundit;
- të kryejë rregullimin e fundit pas kryerjes së provës;
- të qepë sipas rradhës fundin me pala dhe xhepa;
- të fiksojë drejt materialin ngjites me pëlhurë;
- të qepë astarin (nëse ka);
- të bashkojë astarin (nëse ka);
- të kontrollojë saktësinë e proceseve të qepjes së fundit;
- të kryejë punimet e nevojshme përfundimtare;
- të vendosë aksesorë të ndryshëm;
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të fundit;
- të paketojë dhe ambalazhojë fundin me pala dhe xhepa;
- të llogarisë koston e produktit të realizuar;
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti kryen procesin përfundimtar të fundeve për femra me pala dhe xhepa.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë;
- të kryejë proceset përfundimtare të qepjes me dorë të fundeve për femra me pala dhe xhepa;
- të kryejë proceset përfundimtare të qepjes me dorë të fundeve për femra me xhepa dhe xhepa;
- të kryejë qepjen palës së fundit me dorë;
- të kryejë qepjen e xhepave;
- të kryejë qepjen e zinxhirit, sustave, etj.;
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të fundeve për femra me pala dhe xhepa;
- të kryejë paketimin e fundeve për femra me pala dhe

xhepa;

- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës;
- të llogarisë koston e fundeve për femra me pala dhe xhepa;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë prerjes së fustanit;
- të llogarisë koston e produktit të realizuar;
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë, fasoneri, atelie.
